



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:085741

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06217688

C.nr.871/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), me seli në Prishtinë, - Distrikti në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson F.Z. kundër të paditurve: B.E. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. E.Gj. nga Prizreni dhe E.M. nga Mamusha, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit material, vlera e kontestit 2,068.57 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prani të të autorizuarës së paditëses dhe të autorizuarës së të paditurit B.E. më datë 03.09.2024 mori, ndërsa më datë 27.09.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), me seli në Prishtinë.

II. DETYROHET i padituri E.M. nga Mamusha, që në emër të kompensimit të dëmit material të shkaktuar për shkak të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike, paditëses t'ia paguajë shumën prej 925,865 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë më datë 17.07.2020 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET i padituri E.M. që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 180.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses ndaj të paditurit E.M. përtej shumës së gjykuar si në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 2,068.57 euro, përkatësisht shuma prej 1,142.705 euro dhe pjesa e kërkesëpadisë ndaj të paditurit B.E. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që “të detyrohet i padituri B.E. që në emër të kompensimit të dëmit material të shkaktuar për shkak të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike, paditëses në mënyrë solidare me të paditurin E.M. t'ia paguajë shumën prej 2,068.57 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë më datë 17.07.2020 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm”.

V. DETYROHET paditësja, që të paditurit B.E. t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 711.60 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), me seli në Prishtinë, - Distrikti në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson F.Z. pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi për kompensim dëmi material, kundër të paditurit B.E. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. E.Gj. nga Prizreni, vlera e kontestit 2,068.57 euro.

Në padi theksuar se në njehsorin elektrik që i padituri B.E. është pronar, është shfrytëzuar energjia elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që ka bërë lidhje direkte në rrjetin e tensionit të ulët, duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe duke shpenzuar energjinë elektrike pa matje, kështu që paditëses i është shkaktuar dëm material në vlerë prej 2,068.57 euro. Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj si të bazuar dhe ta detyrojë të paditurin ta paguaj detyrimin.

Me aktvendimin C.nr.871/2020 e datës 15.02.2024, gjykata ka lejuar ndryshimin e padisë të paditëses, sipas deklaramit të të autorizuarës së paditëses të datës 18.12.2023, duke lejuar në anën e të paditurit edhe E.M. nga Mamusha.

E autorizuar e të paditurit B.E. në përgjigje në padi ka theksuar që e konteston padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Padia e paditëses nuk është e kuptueshme dhe arsyeshme siç përcaktohet në nenin 99 të LPK-së, ngase duhet theksuar edhe faktet mbi të cilat e bazon kërkesën dhe provat me të cilat vërtetohen ato. Nuk është kontestuese që i padituri B.E. objektin afarist- pompën e benzinës, në bazë të kontratës mbi qiranë të vërtetuar te noteri LRP.nr.144/2015 të datës 25.02.2015, ia ka dhënë me qira të paditurit E.M. nga Mamusha, në afat prej 8 vitesh. I njëjti pasi e ka marrë në posedim lokalin në fjalë, ka bërë meremetime të ndryshme, ka instaluar tërësisht rrymën, duke e vendosur instalimin e ri dhe se çka ka bërë ai, i padituri B.E. nuk mund ta dijë, sepse lokalin e ka pasur në shfrytëzim të pandërprerë. Në aspektin subjektiv, i padituri B.E. nuk ka legjitimitet pasiv të jetë palë e paditur, pasi që nga momenti që e ka dhënë me qira objektin afarist në bazë të kontratës, ai fare nuk ka pasur qasje në atë lokal, ngase rasti- shfrytëzimi i energjisë elektrike jashtë njehsorit elektrik është hasur më datë 23.03.2017, derisa i padituri E.M. e ka pasur në shfrytëzim me qira lokalin afarist dhe kjo vërtetohet edhe nga procesverbali i personave të autorizuar të të paditurës. Andaj, ka propozuar që gjykata ta refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Gjykata me njoftimin C.nr.871/2020 e datës 19.12.2023, ka ftuar të paditurin E.M. që të deklarohe lidhur me zgjerimin e padisë në këtë çështje juridike, mirëpo i njëjti brenda afatit të përcaktuar nuk është deklaruar.

Në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare, e autorizuar e paditëses, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Ka shtuar se në bazë të provave të administruara në këtë çështje juridike, padia dhe kërkesëpadia është e bazuar dhe arsyetuar në ligj. Përkatësisht në bazë të procesverbalit të datës 23.03.2017, ekziston konstatimi i keqpërdorimit të energjisë elektrike, me ç'rast si pasojë e këtyre veprimeve paditëses i është shkaktuar dëm material në vlerë prej 2,068.57 euro, ku kjo lartësi është bazuar në bazë të faturës DPZ17FF11760 të datës 24.03.2017, kalkulim ky i bërë sipas procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike të aprovuar

nga ZRRE. Lidhur me këtë edhe në bazë të ekspertizës së elektroteknikës nga lënda penale numër P.nr.2352/2017, punuar nga eksperti M.Gj. më datë 06.01.2020, është vërtetuar se ekziston keqpërdorimi i energjisë elektrike. Sa i përket pjesës së përgjegjësisë për kompensimin e dëmit material, i referohemi nenit 190 par. 3 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (LMD), ashtu që në rastin konkret kemi të bëjmë me shkaktim të dëmit nga disa persona, secili prej tyre është përgjegjës për shpërblimin e dëmit edhe në qoftë se nuk mund të vërtetohen pjesët e secilit prej tyre veç e veç në dëmin e shkaktuar, atëherë çdonjëri nga ta është përgjegjës për gjithë dëmin e shkaktuar. Sa i përket ekspertizës të punuar nga ana e ekspertit B.F. plotësuar sot më datë 03.09.2024, propozoj që gjykata t'ia fal besimin në tërësi. Andaj, propozon që padia dhe kërkesëpadija e paditëses të aprovohet e bazuar, po ashtu kërkojmë shpenzimet e procedurës, në emër të taksës gjyqësore shumë prej 30.00 euro dhe në emër të përpilimit të ekspertizës së elektros shumë prej 150.00 euro.

Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, e autorizuara e të paditurit B.E. ka deklaruar se pas administrimit të provave, vërtetohet se nuk ekziston baza për të kërkuar nga i padituri B.E. kompensimin e dëmit, ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me ngritjen e padisë ndaj një personi që nuk ka legjitimitet pasiv. Kjo vërtetohet nga kontrata mbi qiranë e noterizuar më datë 05.02.2015, nga e cila vërtetohet se i padituri E.M. e merr objektin afarist-pompën e benzinës si qiramarrës nga trashëgimtarët e të ndjerit B.E.- B.E. dhe E.E. ku ky i fundit fare nuk është përfshirë si i paditur. Lokalini afarist i padituri E.M. e ka pasur në shfrytëzim nga data 15.03.2015 deri në vitin 2019, fakt i cili vërtetohet edhe nga propozimi për sigurimin e provës të paraqitur nga i padituri E.M. me numër CN.nr.72/2019. Prej momentin kur e ka dhënë me qira lokalini, i padituri B.E. fare nuk ka pasur qasje në atë lokal. Shfrytëzimi i energjisë elektrike jashtë njehsorit është hasur më datë 23.03.2017, që do të thotë në kohën kur objekti ka qenë në posedim nga i padituri E.M. Edhe nga ekspertiza e ekspertit të elektroteknikës Ing. M.Gj. dhe nga ana e deklaratave të dëshmitarëve të dhënë në procedurë penale, është vërtetuar se instalimi i energjisë elektrike ka qenë i vendosur ku është ndërtuar objekti, mirëpo as eksperti në fjalë e as dëshmitarët të cilët kanë qenë në kontroll, nuk kanë mundur të vërtetojnë kohën kur është bërë keqpërdorimi. Mirëpo me dëgjimin e E. nga propozimi për sigurimin e provës dhe të paditurit B.E. si dëshmitarë, është vërtetuar se E. ka bërë mjaft investime, duke ndërruar pompat, llampat dhe ka instaluar rrymën në lokal. Nga deklarata e ekspertit B.F. gjatë shqyrtimit kryesor, vërtetohet se llogaritja është bërë për një vit prapa dmth. është zbuluar në vitin 2017, ndërsa kompensimi lidhur me këtë bëhet në periudhë retroaktive 12 mujore, pra në vitin 2016. Gjithashtu, në seancën e datës 18.12.2023 edhe pse kemi kundërshtuar ndryshimin e padisë në aspektin subjektiv, gjyqtari i rastit me aktvendimin e datës 15.02.2024 ka lejuar ndryshimin e padisë dhe vlerësojmë se është cenuar neni 254 i LPK-së. Andaj, gjykatës i ka propozuar që padinë e paditëses ta refuzoj të pabazuar për shkak të mungesës së legjitimitetit në anën e të paditurit B.E. shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, për përgjigje në padi shumë prej 135.00 euro, për pesë seanca nga 135.00 euro, gjithsej 810.00 euro.

Gjykata shqyrtimin kryesor në këtë çështje juridike e ka mbajtur në mungesë të të paditurit E.M. në përputhje me nenin 423 par. 4 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), pasi që i padituri është ftuar rregullisht dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Gjendja faktike e vërtetuar dhe provat e administruara

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: ekspertizën elektrike të datës 18.06.2024 dhe

plotësimin e datës 03.09.2024, punuar nga eksperti B.F. nga Mitrovica, deklarin e ekspertit të inxhinierisë elektrike B.F aktgjykimit P.nr.2352/17 e datës 16.03.2020, kallëzimin penal numër 643 i datës 28.04.2017, procesverbalin numër 2428381 e datës 23.03.2017, fotodokumentacionin- 8 fotografi, kalkulimin e RH e datës 24.03.2017, faturën DPZ17HP11760 e datës 24.03.2017, kartelën e konsumatorit numër 9030859 në emër të B.E. ekspertizën e elektroteknikës nga lënda penale P.nr.2352/2017, punuar nga eksperti M.Gj. më datë 06.01.2020, kontratën mbi qiranë e lidhur ndërmjet E.E. dhe të paditurit B.E. si qiradhënës dhe NPT “... Commerce”, të pasuar nga i padituri E.M. si qiramarrës, më datë 05.02.2015, propozimin për sigurimin e provës në lëndën CN.nr.72/2019.

Gjykata pas vlerësimit të theksimeve të palëve dhe provave të administruara në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

- kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Nga leximi i ekspertizës elektrike të datës 18.06.2024 dhe plotësimin e datës 03.09.2024, punuar nga eksperti B.F. nga Mitrovica, vërtetohet se është bërë keqpërdorimi i energjisë elektrike, përkatësisht shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike dhe se vlerësimi i këtij keqpërdorimi rezulton të jetë në lartësi prej 1,804.56 euro. Ndërsa, nga plotësimi i ekspertizës të datës 03.09.2024, u vërtetua se keqpërdorimi i energjisë elektrike rezulton të jetë në lartësi prej 1,851.73 euro

Eksperti i inxhinierisë elektrike B.F. gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se sipas procesverbalit numër 2428381 të datës 23.03.2017, më datë 23.03.2017 është zbuluar keqpërdorimi, ndërsa sa i përket kalkulimit të rikthimit të humbjeve, në bazë të rregullores, procedura për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike për konsumatorë komercial, rikthimi i humbjeve llogaritet prej datës kur është zbuluar keqpërdorimi, 12 muaj prapa, ndërsa sa i përket se kush ka qenë shfrytëzues nuk mund ta di, pra kalkulimi bëhet për njehsor dhe për keqpërdorimin e atij njehsori.

Nga leximi i aktgjykimit P.nr.2352/17 e datës 16.03.2020, vërtetohet se i padituri E.M. është liruar nga akuza për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Nga leximi i kallëzimit penal numër 643 i datës 28.04.2017, vërtetohet se paditësja ka ngritur kallëzim penal ndaj të paditurit E.M. pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, për shkak të dyshimit se i njëjti nga data e pavërtetuar e deri më datë 23.03.2017, ka bërë shfrytëzimin e energjisë elektrike pa autorizim, ashtu që në lokalit të cilin e ka shfrytëzuar i padituri, është gjetur një lidhje direkte nga ormani kryesor, duke bërë që me një veprim të tillë energjia e shpenzuar të mos regjistrohet.

Nga leximi i procesverbalit numër 2428381 i datës 23.03.2017, është vërtetuar se ekipi i kontrollit të paditëses, në lokalit afarist ku shfrytëzues ishte i padituri E.M. kanë hasur në njehsor të pa bllobuar dhe se në lokal është krijuar një lidhje direkte, ku energjia e shpenzuar nuk është regjistruar dhe faturuar.

Nga shikimi i fotodokumentacionit- 8 fotografi, u vërtetua se ekipi i kontrollit të paditëses, më datë 23.03.2017 ka realizuar fotografi të njehsorit elektrik të lokalit afarist të cilin e shfrytëzonte i padituri E.M. dhe fotografi të disa pajisjeve elektrike.

Nga leximi i kalkulimit të RH i datës 24.03.2017, është vërtetuar se sipas kalkulimit të departamentit special të paditëses, energjia që duhet faturuar si pasojë e shpenzimit të paautorizuar nga shfrytëzuesi i lokalit afarist është në lartësi prej 1,681.00 KWh.

Nga leximi i faturës DPZ17HP11760 e datës 24.03.2017, u vërtetua se sipas llogaritjeve të bëra nga paditësja, shuma e faturës për shkak të rikthimit të humbjeve, për 1,681.00 KWh është 2,068.57 euro.

Nga leximi i kartelës së konsumatorit numër 9030859 në emër të B.E. është vërtetuar se lokali afarist të cilin e shfrytëzonte i padituri E.M. ka qenë në emër të personit B.E.

Nga leximi i ekspertizës së elektroteknikës nga lënda penale P.nr.2352/2017, punuar nga eksperti M.Gj. më datë 06.01.2020, vërtetohet se instalimi i prizave është punuar kur është punuar lokali dhe objekti, kabllot e instalimit janë të vendosura në ormanin kryesor, ormani kyçës jashtë lokalit është në pjesën e kundërt të ormanit kryesor në brendi të objektit, nga ana e ormanit kyçës shihen intervenimet në pjesën e jashtme. Po ashtu, nga kjo provë vërtetohet se manipulimet me kabllot nga ormani kryesor deri te ormani kyçës mund të bëhet pa dëmtime të llaqit, ndërmjet ormanëve është muri i cili është i depërtueshëm.

Nga leximi i kontratës mbi qiranë LRP.nr.144/2015 e datës 25.02.2015, u vërtetua se ndërmjet E.E. dhe të paditurit B.E. si qiradhënës dhe NPT "... Commerce", me pronar të paditurin E.M. si qiramarrës, objekti afarist pompa e benzinës e cila gjendet në Mamushë, nga qiradhënësit t'i jepet në shfrytëzim me kompensim prej 8 vitesh (nga data 15.03.2015 deri më 15.03.2023), qiramarrësit- të paditurit E.M. në çmimin mujor prej 800.00 euro.

Nga leximi i propozimit për sigurimin e provës në lëndën CN.nr.72/2019, vërtetohet se i padituri E.M. në cilësi të propozuesit, ka parashtruar propozim për sigurimin e provës, ndaj të paditurit B.E. dhe E.E. në cilësi të kundërpropozuesit, lidhur me objektin afarist në pompën e benzinës në Mamushë.

Baza ligjore

Me nenin 136 par. 1. të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se "kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij". Në nenin 140 të po këtij ligji parashihet se "fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia". Në bazë të kësaj dispozite pala përgjigjet për dëmin e shkaktuar me dashje dhe nga pakujdesia.

Në nenin 169 par. 1 të LMD-së thuhet që "personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi". Ndërsa, në nenin 190 par. 1 të LMD-së përcaktohet se "për dëmin të cilin disa persona e kanë shkaktuar bashkërisht, përgjigjen të gjithë pjesëmarrësit solidarisht".

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja i është shkaktuar dëm material për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.

Mirëpo kontestuese ishte se kush është përgjegjës për shkaktimin e dëmit të pësuar nga paditësja dhe lartësia e dëmit material të pësuar.

Në këtë drejtim, gjykata bazuar në ekspertizën elektrike të datës 18.06.2024, punuar nga eksperti B.F. nga Mitrovica dhe deklarimin e ekspertit gjatë shqyrtimit kryesor, erdhi në përfundim se paditësja ka pësuar dëm, përkatësisht më datë 23.03.2017 është zbuluar keqpërdorimi i energjisë elektrike, në lokalin afarist- pompën e benzinës të cilën e shfrytëzonte i padituri E.M. Po ashtu, fakti se paditësja ka pësuar dëm, përkatësisht që keqpërdorimi i energjisë elektrike ka ndodhur më datë 23.03.2017, vërtetohet edhe nga procesverbali numër 2428381 e datës 23.03.2017 dhe ekspertiza e elektroteknikës nga lënda penale P.nr.2352/2017, punuar nga eksperti M.Gj. më datë 06.01.2020. Andaj, duke pas parasysh faktin se sipas kontratës mbi qiranë LRP.nr.144/2015 e datës 25.02.2015, i padituri E.M. nga data 15.03.2015 deri më 15.03.2023, e ka shfrytëzuar si qiramarrës objektin afarist- pompën e benzinës e cila gjendet në Mamushë, gjykata ka ardhur në përfundim se i padituri E.M. ka përgjegjësi në keqpërdorimin e energjisë elektrike më datë 23.03.2017. Andaj, mbi këtë bazë gjykata gjeti se i padituri E.M. ka përgjegjësi në dëmin e shkaktuar paditëses, si pasojë e keqpërdorimit të energjisë elektrike të hasur më datë 23.03.2017, pasi që i njëjti në këtë datë e ka pasur në shfrytëzim objektin afarist- pompën e benzinës.

Në anën tjetër, sa i përket lartësisë së dëmit të pësuar nga paditësja, gjykata këtë e mbështeti në ekspertizën elektrike të datës 18.06.2024, punuar nga eksperti B.F. nga Mitrovica, përkatësisht në plotësimin e ekspertizës elektrike të datës 03.09.2024. Kështu, ekspertizës elektrike dhe plotësimit të lartcekur, gjykata ia fali besimin e plotë, për arsye se ekspertiza është përpiluar në mënyrë profesionale, e bazuar në bazë të qartë ligjore dhe dispozita ligjore përkatëse, e njëjta në mënyrë të detajuar, konkrete dhe reale pasqyron kalkulimin e lartësisë së dëmit material që paditësja ka pësuar nga veprimi i kundërligjshëm e që është në lartësi prej 1,851.73 euro. Andaj, për konstatimin e lartësisë së dëmit, detyrimisht nevojitet nxjerrja e ekspertizës së elektros, të cilën gjykata e ka bërë sipas propozimit të palës paditëse, sepse nga faturat e njëanshme të nxjerra dhe të kalkuluara nga vetë pala paditëse, përkatësisht kalkulimi i RH e datës 24.03.2017 dhe fatura DPZ17HP11760 e datës 24.03.2017, nuk mund vërtetohet lartësia e dëmit, sepse të njëjtat për gjykatën konsiderohen prova të njëanshme dhe jo objektive. Së këndejmi, gjykata ia fali fuqinë e plotë provuese ekspertizës elektrike të datës 18.06.2024, punuar nga eksperti B.F. dhe plotësimit të ekspertizës elektrike të datës 03.09.2024, lidhur me vërtetimin e lartësisë së dëmit material.

Kësisoj, duke marrë për bazë faktin që sa i përket lartësisë së dëmit gjykata ia fali besimin ekspertizës elektrike të datës 18.06.2024 dhe plotësimit të ekspertizës elektrike të datës 03.09.2024, sipas të cilës dëmi i pësuar nga paditësja është në lartësi prej 1,851.73 euro dhe kërkesën e paditëses që të detyrohen në mënyrë solidare të paditurit: B.E. dhe E.M. në kompensimin e dëmit, gjykata vendosi që të aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit. Më konkretisht, gjykata aprovoi pjesërisht kërkesën e paditëses ndaj të paditurit E.M. duke e detyruar këtë të fundit që paditëses t'ia kompensoj shumën prej 925,865 euro, në emër të kompensimit të dëmit material.

Në anën tjetër, gjykata e refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit, pasi që e njëjta nuk ishte e bazuar në fakte dhe prova. Më saktësisht, gjykata e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses ndaj të paditurit E.M. për arsye se e njëjta nuk gjen mbështetje në ekspertizën elektrike të datës 18.06.2024 dhe plotësimin e ekspertizës elektrike të datës 03.09.2024, e të cilës gjykata ia fali fuqinë e plotë

provuese. Kështu, kjo pjesë e refuzuar e kërkesëpadisë së paditëses ndaj të paditurit E.M. është bazuar në faturën DPZ17HP11760 e datës 24.03.2017, por kësaj prove, përkatësisht diferencës ndërmjet këtyre dy provave, gjykata nuk ia fali besimin. Gjithashtu, gjykata e ka refuzuar pjesën e kërkesës së paditëses ndaj të paditurit B.E. pasi që me asnjë provë paditësja nuk ka arritur të provojë se i padituri B.E. është përgjegjës për shkaktimin e dëmit ndaj paditëses. Më saktësisht, paditësja nuk ka arritur të provojë dhe vërtetojë lidhjen kauzale ndërmjet veprimit të kundërligjshëm të të paditurit B.E. dhe pasojës së shkaktuar, përkatësisht dëmit të pësuar nga paditësja.

Gjykata ka analizuar pretendimin e të autorizuarës së të paditurit B.E. se gjykata ka shkelur dispozitat ligjore të LPK-së kur ka lejuar ndryshimin- zgjerimin e padisë edhe ndaj të paditurit E.M. mirëpo gjeti se një pretendim është tërësisht i pabazuar. Kështu, gjykata vlerëson se lejimi i ndryshimit të padisë është bërë në përputhje me nenin 258 par. 1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 264 par. 2 të LPK-së.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (17.07.2020), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimi për detyrimin e të paditurit E.M. për pagimin e shpenzimeve gjyqësore ndaj paditëses është marrë konform nenit 452 par. 1 të LPK-së, ku gjykata e obligoi palën e paditur t'ia paguajë shpenzimet procedurale paditëses dhe atë për taksën gjyqësore në shumën prej 30.00 euro si dhe për shpenzimet e ekspertit për hartimin e ekspertizës shumën prej 150.00 euro.

Po ashtu, gjykata ka vendosur që të detyrohet paditësja në kompensimin e shpenzimeve procedurale ndaj të paditurit B.E. në përputhje me nenin 452 par. 1 dhe 453 par. 2 të LPK-së, shumën prej 104.00 euro në emër të përgjigjes në padi, 540.00 euro për 4 seanca gjyqësore (shumën e kërkuar nga pala e paditur prej 135.00 euro) dhe shumën prej 67.60 euro për 1 seancë gjyqësore. në shumën e përgjithshme prej 711.60 euro.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore të cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi, lidhur me nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.871/2020, datë 27.09.2024

Gjyqtari
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:085741
Datë: 27.09.2024
Numri i dokumentit: 06217688